



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 475 / prot.
7

Tiranë, më 28 . 3 .2025

V E N D I M

Nr. 7, datë 28.3.2025

P Ë R

**PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR NDIHMËS LIGJORË DHE
GJYQTAR 2024-2025, TË CILËT KANË KALUAR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË
PASURISË DHE FIGURËS NGA KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve magistratë që pranohen në Shkollën e Magjistraturës në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 248, 266 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, datë 18.2.2025, vendimit nr. 138, datë 6.3.2025 dhe vendimit nr. 166, datë 18.3.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, më datë 28.3.2025,

V E N D O S I:

1. Të publikojë listën e kandidatëve për ndihmës ligjor dhe gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025, të cilët kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas listës bashkëngjitur pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.